**VENDIM**
**Nr.281, datë 28.4.2005**

**PËR DHËNIEN NË ADMINISTRIM TË PËRKOHSHËM ALBPETROL SHA-SË, PATOS, TË NJË SIPËRFAQEJE TOKE, TË NEVOJSHME PËR SHPIMIN DHE VËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PUSIT DELVINA-34**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14 e 15 shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqërisë anonime Albpetrol, Patos t'i jepet në administrim të përkohshëm, pa shpërblim, sipërfaqja prej 7000 $m^2$, në zonën gazmbajtëse Delvinë, në parcelat e kadastruara me nr.21 e nr.22, të emërtuara "Llakopin", zonë pyjore shtetërore me koordinata X=4424100, Y=4425430, Z=410, në ekonominë pyjore, Dhrovjan.

2. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**